Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raport i Auditimit
të Teknologjisë së Informacionit

SISTEMI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE TË KOSOVËS



Prishtinë, tetor 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000[2] dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100[3]).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit[4], ekonomisë[5], dhe efektivitetit[6] të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit "Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (RBK)" në konsultim me Drejtorin e Departamentit të Auditimit Samir Zymberi, e cila e ka mbikëqyrur e menaxhuar auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit; dhe
Atdhe Gashi, Anëtar i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
http://zka-rks.org

[1] Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.
[2] SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.
[3] GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI.
[4] Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës
[5] Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë.
[6] Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 5

1 Hyrje 7

2 Objektivi dhe fushat e auditimit 9

3 Gjetjet e auditimit 10

3.1 Kontrollet e aplikacionit 10

4 Konkluzionet 19

5 Rekomandimet 21

Shtojca I. Dizajni i auditimit 23

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit 23

Përshkrimi i sistemit 24

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit 27

Kriteret e auditimit 28

Metodologjia e auditimit 29

Dokumentet relevante 30

Shtojca II. Letër konfirmimi 31

Lista e shkurtesave

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
GG	Government Gateway (Porta Qeveritare)
MINTI	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
NUI	Numri Unik Identifikues
RBK	Regjistri i Bizneseve të Kosovës
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
TI	Teknologjia Informative

Përmbledhje e përgjithshme

Sistemi i Regjistrit të Bizneseve të Kosovës përfaqëson një komponent kyç të infrastrukturës shtetërore për regjistrimin, administrimin dhe menaxhimin e të dhënave të bizneseve në Republikën e Kosovës. Sistemi mbështet ofrimin e shërbimeve elektronike për bizneset dhe qytetarët, duke mundësuar regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e bizneseve, si dhe duke kontribuar në rritjen e transparencës, standardizimit dhe efikasitetit të proceseve administrative. Për më tepër, integrimi i tij me platformën e-Kosova ka krijuar bazën për avancimin e transformimit digjital të shërbimeve publike në këtë fushë.

Rezultatet e auditimit tregojnë se sistemi ka arritur të mbështesë në masë të konsiderueshme proceset bazë të regjistrimit dhe administrimit të bizneseve, duke ofruar një platformë funksionale për menaxhimin e të dhënave dhe bashkëpunimin ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe bizneseve - qytetarëve. Megjithatë, vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit dhe sigurisë së aplikacionit ka identifikuar mangësi që kufizojnë automatizimin e proceseve, cilësinë e kontrolleve të aplikacionit dhe nivelin e sigurisë së informacionit.

Në aspektin e **kontrolleve të hyrjes**, është evidentuar se sistemi nuk siguron në tërësi validimin automatik të të dhënave hyrëse dhe zbatimin e plotë të kërkesave ligjore dhe biznesore. Mungesa e identifikimit të qartë të fushave obligative, udhëzimeve për përdoruesit dhe mesazheve specifike të gabimit e vështirëson procesin e aplikimit dhe efikasitetin e sistemit për regjistrimin e biznesit. Po ashtu, rregulla ligjore, si kriteret për dallueshmërinë e emrit të biznesit, nuk janë të integruara në kontrollet automatike të sistemit, duke krijuar nevojë për verifikime manuale dhe duke ndikuar në efikasitetin e procesit dhe si rezultat në vonesa të ofrimit të shërbimit.

Në aspektin e **kontrolleve dalëse**, sistemi nuk ofron mbështetje të plotë për raportim, monitorim dhe automatizim të proceseve. Mungesa e raporteve analitike në nivel komunal, mangësitë në statistikat e bizneseve aktive dhe jo aktive, si dhe kufizimet në funksionalitetet për korrigjimin e lëndëve ndikojnë në cilësinë e monitorimit dhe vendimmarrjes. Gjithashtu, proceset e regjistrimit, ndryshimit dhe çregjistrimit të bizneseve nuk janë plotësisht të digjitalizuara, pasi vazhdojnë të mbështeten pjesërisht në dokumentacion fizik dhe procedura manuale. Kjo ka ndodhur për shkak të legjislacionit që krijon kufizime dhe mungesës së disa funksionaliteteve dhe integrimeve ndërinstitucionale, që ndikon në efikasitetin e realizimit të procesit përmes sistemit dhe vonesa në ofrimin e shërbimeve.

Sa i përket **sigurisë së aplikacionit**, auditimi ka konstatuar se, megjithëse ekzistojnë masa teknike operative për menaxhimin e ndryshimeve dhe realizimin e kopjeve rezervë, mungesa e politikave dhe procedurave të formalizuara kufizon efektivitetin e qeverisjes së sigurisë së informacionit. Dobësitë në menaxhimin e fjalëkalimeve, mungesa e një procesi të formalizuar për menaxhimin e ndryshimeve, përqendrimi i roleve kritike te një zyrtar i vetëm i TI-së, si dhe mungesa e procedurave të dokumentuara për rikthim nga fatkeqësia, rrisin rrezikun për qasje të paautorizuar, dobësim të kontrolleve të brendshme dhe vështirësi në sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve në rast të incidenteve.

Prandaj, çështjet dhe rreziqet e identifikuara më lartë, tregojnë që Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), e cila administron Sistemin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Lidhur me këtë, kemi dhënë gjithsej 16 rekomandime, të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entitetit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, ka pranuar gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) është agjencia e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe ka si aktivitet kryesor regjistrimin dhe ri-regjistrimin e bizneseve të ndryshme, përfshirë bizneset individuale, ortakëritë (të përgjithshme dhe të kufizuara), shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe ato aksionare, si dhe kompani të huaja, ndërmarrje publike e shoqërore, kooperativa bujqësore dhe subjekte të tjera nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit; gjithashtu, në kuadër të saj realizohet edhe licencimi i kompanive të sigurimit fizik.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përmes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, administron sistemin e regjistrimit të bizneseve në Kosovë. Përmes kësaj agjencie, ministria siguron që bizneset të regjistrohen në mënyrë ligjore dhe të pajisen me numër unik identifikues. Gjithashtu, ajo mundëson mirëmbajtjen e një regjistri të saktë dhe transparent të bizneseve, përditësimin e të dhënave të tyre duke kontribuar kështu në funksionimin e rregullt të tregut.

Sipas të dhënave nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, në Kosovë deri në vitin 2026 janë të regjistruara 265,992 biznese gjithsej, duke reflektuar nivelin e zhvillimit të sektorit privat në vend. Prej tyre: 134,914 biznese kanë statusin aktiv, 93,532 biznese kanë statusin pasiv, 37,546 biznese janë të çregjistruara.

Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve, ka ndërlidhje përmes platformës ndërmjetëse (Government Gateway – GG), e cila mundëson shkëmbimin dhe ofrimin e të dhënave për institucione të ndryshme shtetërore.

Në mënyrë konkrete, sistemi është i ndërlidhur me:

- Administratën Tatimore të Kosovës – ku realizohet shkëmbim i dyanshëm i të dhënave për bizneset;
- Regjistrin e Gjendjes Civile – nga i cili konsumohen të dhëna për qytetarët e Republikës së Kosovës përmes GG-së;
- Doganën e Kosovës – e cila merr të dhëna nga Regjistri i Bizneseve;
- Agjencinë Kadastrale të Kosovës – nga e cila konsumohen të dhëna për adresat zyrtare.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve bën regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare dhe shoqërive të huaja tregtare konform Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare si dhe Ligjit Nr.06/L-016 për ndryshimet dhe plotësimin e ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Përmes rrjetit të 36 qendrave komunale të regjistrimit, të lidhura me zyrën qendrore të ARBK-së, ofrohet një shërbim i unifikuar dhe i koordinuar në të gjithë territorin e Kosovës. Ky sistem "one-stop-shop" është krijuar për të ofruar një përvojë të lehtë dhe efikase për bizneset, duke ulur burokracinë dhe duke rritur transparencën.

Sistemi i Regjistrit të Bizneseve në Kosovë është një platformë elektronike që u mundëson përdoruesve të regjistrohen në sistem dhe të aplikojnë online për regjistrimin e bizneseve, gjithashtu ofron qasje edhe përmes qasjes së tyre në platformën e-Kosova, si dhe të paraqesin kërkesa për ndryshime dhe shërbime të tjera administrative. Pas konfirmimit të llogarisë, përdoruesit mund të menaxhojnë të dhënat e bizneseve të tyre në mënyrë elektronike.

Sistemi për regjistrimin e bizneseve përfshin një gamë të gjerë funksionesh që mbulojnë të gjithë ciklin jetësor të një biznesi, nga krijimi fillestar deri te ndryshimet dhe ç'regjistrimi, që deri më tani online në platformën e-Kosova është zbatuar vetëm pjesa e regjistrimit.

Sistemi u mundëson përdoruesve regjistrimin e llojeve të ndryshme të bizneseve si Biznes Individual, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (ShPK), Shoqëri Aksionare, Ortakëri të Përgjithshme, Ortakëri të Kufizuara, Kompani të Huaja dhe Kooperativa Bujqësore.

Në sistemin për regjistrimin e bizneseve, përveç regjistrimit të bizneseve, sistemi ofron edhe mundësinë për ndryshimin e të dhënave të biznesit, ndryshimin e adresës, aktiviteteve, kapitalit, pronarëve, përfaqësuesve dhe çregjistrimin e biznesit.

2 Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit dhe sigurisë së aplikacionit për Sistemin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për MINTI-në, përkatësisht ARBK-në, dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e regjistrit të bizneseve, në mënyrë që të përmirësojnë kontrollet e aplikacionit në sistemin e informacionit për regjistrimin e bizneseve.

Tabela 1: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Kontrollet e Aplikacionit	1. Kontrollet e hyrjes
	2.Kontrollet e të dhënave dalëse
	3.Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), me qendrat komunale për regjistrimin e bizneseve (gjatë këtij auditimi janë përfshirë dy qendra komunale si mostra testuese, Ferizaj dhe Fushë Kosova), e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Regjistrimit të Bizneseve dhe divizioni përkatës për administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Qëllimi i këtij auditimit është vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit për sistemin e teknologjisë së informacionit "Sistemin për regjistrimin e bizneseve në Kosovë", me fokus në kontrollet e hyrjes, kontrollet dalëse dhe kontrollet e sigurisë së aplikacionit. Auditimi mbulon periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2026, duke përfshirë edhe kontratën fillestare me termat e referencës për zhvillimin e sistemit të vitit 2019.

3 Gjetjet e auditimit

Misioni i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve është të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e biznesit në Kosovë, duke ofruar shërbime të besueshme dhe efikase.

Në përgjithësi, sistemi i Regjistrit të Bizneseve të Kosovës përbën një bazë të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve elektronike dhe ka kontribuar në modernizimin e administrimit të bizneseve. Megjithatë, ekzistojnë mangësi në kontrollet e aplikacionit dhe sigurinë e tij. Janë evidentuar dobësi në validimet automatike të të dhënave, raportimin, integrimet ndërinstitucionale dhe automatizimin e proceseve. Gjithashtu, nuk janë hartuar dhe zbatuar në mënyrë të plotë politika dhe procedura të formalizuara për menaxhimin e sigurisë së aplikacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Si rezultat, rritet varësia nga proceset manuale, ndërsa efikasiteti, besueshmëria dhe qëndrueshmëria e sistemit, si dhe cilësia e shërbimeve për bizneset, mund të ndikohen negativisht.

Gjatë muajit gusht 2026 janë raportuar dyshime për ekspozim të mundshëm të të dhënave personale përmes sistemit të RBK-së të cilat mund të cenojnë privatësinë. Lidhur me këtë ekipi i auditimit, në kohen e draftimit të raportit, ka vizituar ARBK-në dhe ka verifikuar funksionalitetin e Sistemit të Regjistrimit të Bizneseve lidhur me publikimin e Statutit dhe anonimizimin e të dhënave personale. Është konstatuar se ARBK kishte aktivizuar një funksionalitet në portalin e tyre, pas konsultimeve me Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe pas testimeve paraprake. Por pas lëshimit në funksion është raportuar në media për ekspozimin e mundshëm të të dhënave personale (në ARBK nuk janë raportuar rastet e tilla). Lidhur me këtë ARBK ka reaguar dhe si rezultat ka ndërprerë përkohësisht funksionalitetin deri në zhvillimin e një zgjidhjeje të re. Ndërsa si shkaqe të mundshme janë identifikuar cilësia e dobët e dokumenteve të skanuara dhe ngarkesa në sistem, shkaku përfundimtar teknik nuk ishte përcaktuar.

Ekipi i auditimit përmes testimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës, ka konfirmuar ndërprerjen e këtij funksionaliteti në Portalin e ARBK-së.

Në vijim janë paraqitur çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e hyrjes, kontrollet e të dhënave dalëse dhe kontrollet e sigurisë së aplikacionit.

3.1 Kontrollet e aplikacionit

Kontrollet e aplikacionit janë: kontrolli mbi funksionin e hyrjes, të përpunimit, të daljes dhe sigurisë. Ato përfshijnë metoda për të siguruar që: vetëm të dhëna të plota, të sakta, të vlefshme dhe të besueshme vendosen dhe azhurnohen në një sistem të informacionit, përpunimi realizon detyrën e saktë dhe rezultati i përpunimit plotëson pritjet dhe të dhënat ruhen.[7]

[7] Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Kontrollet e aplikacionit.




Figura 1. Kontrollet e Hyrjes

1. Fushat obligative në formularin e regjistrimit të biznesit përmes platformës e-Kosova nuk janë të identifikueshme për qytetarin

Rregullat e vlefshmërisë në sistemin për regjistrimin e bizneseve duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit. [8]

Qytetari në platformën e-Kosova mund të regjistrojë Biznes Individual, Ortakëri të Përgjithshme, Ortakëri të Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Kompani të Huaj, Zyrë të Përfaqësimit në Kosovë dhe Kooperativë Bujqësore. Fushat gjatë plotësimit në e-Kosova ofrojnë mundësi për plotësimin e formularit të aplikacionit për regjistrim biznesi.
Mirëpo, nuk ka sqarime në formë shembulli se si duhet të plotësohen fushat. Për më tepër, fushat obligative nuk janë të dallueshme si të tilla për plotësim obligativ. Edhe pse, qytetari nuk mund të vazhdojë në hapin tjetër pa i plotësuar fushat obligative, mirëpo mesazhi i gabimit është i përgjithshëm dhe nuk e sqaron qytetarin se për cilën fushë po shfaqet gabimi në plotësim.
Për më tepër, qytetari nuk mund ta identifikojë statusin e lëndës së regjistruar përmes platformës e-Kosova, se në cilën hap të shqyrtimit ndodhet regjistrimi i biznesit të tij. Po ashtu, edhe modulet për ndryshimin dhe ç'regjistrimin e biznesit nuk janë zhvilluar ende në e-Kosova.

Shkak i këtyre mangësive është se platforma e-Kosova nuk kishte kontratë të mirëmbajtjes dhe avancimit në kohën kur është zhvilluar shërbimi i bizneseve në e-Kosova. Për më tepër, zhvillimet e realizuara në e-Kosova janë miratuar në dokumentin për miratimin e zhvillimeve nga ARBK. Këto pritet të realizohen, pasi që në vitin 2026 është nënshkruar kontrata e re për mirëmbajtjen dhe avancimin e platformës e-Kosova.

Si rezultat, ka paqartësi për qytetarët gjatë regjistrimit të biznesit në e-Kosova. Po ashtu, procesi nuk është i kompletuar për pjesën e ndryshimit dhe çregjistrimit, për të cilat qytetarët detyrohen të përdorin alternativa të tjera, ku njëra ndër to është edhe prania fizike në sportelet e ARBK-së. Kjo tregon që qëllimi për digjitalizimin e shërbimeve në e-Kosova nuk ka arritur plotësisht qëllimin.

[8] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

2. Mangësi në zhvillimin e sistemit lidhur me kriteret për emrin unik të biznesit

Të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.[9]

Sistemi i regjistrimit të bizneseve edhe pse është zhvilluar në bazuar në legjislacion, nuk plotëson kërkesat e Ligjit Nr. 06/L -016, Neni 28 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020 për Procedurën e Regjistrimit të Emrit Zyrtar dhe Emrit Tregtar, konkretisht nenin 5, i cili përcakton se emri tregtar duhet të jetë unik, por edhe duhet të dalloj për dy apo më shumë karaktere.

Gjatë testimeve që realizuam, kemi vërejtur se në sistem pranohet të regjistrohet çdo emër biznesi që dallon nga një emër tjetër vetëm për një karakter, qoftë ai një shkronjë, një numër apo edhe një hapësirë.

Si shkak i kësaj mangësie në sistem ishte zhvillimi i aplikacionit me funksione jo komplekse të përdorura gjatë programimit, të cilat zyrtari i TI-së në ARBK-së u arsyetua se, në kohën kur është zhvilluar sistemi, funksionet komplekse e ngadalësonin punën dhe funksionalitetin e sistemit. Prandaj e kanë lënë të pazgjidhur, të pa zbatuar këtë kriter ligjor në sistem por që të trajtohet në mënyrë manuale nga zyrtarët shqyrtues të aplikimeve në komuna dhe në ARBK.

Si pasojë sistemi mundëson regjistrimin e bizneseve me emërtime të ngjashme që nuk janë në përputhje me kriteret ligjore, të cilat shkaktojnë konfuzion në identifikimin e dallimit të bizneseve. Për më tepër, ARBK-ja, më saktësisht zyrtarët për shqyrtimin e aplikimeve, shpenzojnë kohë për identifikimin manual, duke kontrolluar çdo emërtim biznesi në listën e bazës së të dhënave të ARBK-së, gjë që shkakton vonesa në procesimin e lëndëve për regjistrimin e bizneseve.

3. Kthimi i aplikimeve për shkak të mospërputhjes në numrin e punëtorëve

Rregullat e vlefshmërisë në sistemin për regjistrimin e bizneseve duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni.[10]

Fusha për numrin e punëtorëve është obligative dhe duhet të plotësohet për të vazhduar procesi i aplikimit, megjithatë sistemi e pranon edhe vlerën 0 si të vlefshme. Kjo është në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi që Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare nuk përcakton një numër minimal të punëtorëve për format e shoqërive tregtare, si Sh.P.K., Biznes Individual dhe format e tjera. Për këtë arsye, sistemi nuk vendos kufizime për vlerën minimale të kësaj fushe.

Mirëpo, gjatë verifikimeve të auditimit kemi vërejtur se bizneset e llojit Sh.P.K. të cilat kishin aplikuar për regjistrim me numër të punëtorëve 0, aplikimet e tyre kthehen për korrigjim tek pala, nga zyrtari procesues për përmirësimin e numrit të punëtorëve, në mënyrë që të vendoset së paku numri 1 i punëtorëve ose më i madh se 1, pasi që, konsiderohet se me themelimin e biznesit ekziston së paku një individ, përderisa ai mund të jetë edhe pronar.

Në sistem nuk është kufizuar numri i punëtorëve, për shkak se ligji nuk përcakton një kufizim të tillë. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së hartimit të kërkesave për zhvillimin e sistemit pa

[9] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.
[10] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

bashkëpunim nga profesionistë të anës biznesore me pjesën e TI-së. Mirëpo, kjo pjesë u është lënë zhvilluesve dhe teknikëve të TI-së, prandaj edhe sistemi lejon të përdoret edhe numri punëtorëve 0.

Mungesa e hartimit të kërkesave për zhvillimin e sistemit në mënyrë profesionale shkakton konfuzion në zbatimin e kërkesave ligjore në zhvillimin e sistemit dhe si pasojë, kemi vonesa në regjistrimin e bizneseve.




Figura 2. Kontrollet e Daljes

4. Mungesë e funksionalitetit për kufizimin e ndryshimeve vetëm në pjesët e paplotësuara të lëndës gjatë procesit të korrigjimit

ARBK duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[11]

Gjatë auditimit është identifikuar se, pas shqyrtimit të lëndës nga "Zyrtari Aprovues", në rastet kur lënda nuk aprovohet për shkak të mangësive në dokumentacion, mosplotësimit të kritereve ose pasaktësive në të dhënat e paraqitura, lënda i kthehet palës për përmirësim përmes sistemit.
Megjithatë, gjatë kthimit të lëndës për plotësim, sistemi nuk kufizon ndryshimet vetëm në pjesët ku janë identifikuar mangësitë, por i mundëson palës qasje në tërë lëndën dhe mundësinë për të ndryshuar të gjitha të dhënat dhe dokumentet e aplikimit, përfshirë edhe ato pjesë që më herët janë plotësuar saktë dhe janë konsideruar të kompletuara.
Si rezultat, pas përmirësimit të lëndës nga pala, "Zyrtari Aprovues" është i obliguar të rishqyrtojë përsëri të gjithë dokumentacionin dhe të gjitha të dhënat e lëndës, edhe për pjesët që nuk kanë qenë objekt i korrigjimit dhe që më parë ishin verifikuar si të sakta.

[11]Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

Shkaku kryesor i identifikuar është mungesa e një mekanizmi në sistem që i mundëson zyrtarit njoftimin për pjesët e korrigjuara nga pala. Prandaj, sistemi nuk ka një funksionalitet që balancon këtë fleksibilitet me nevojën për ruajtjen e pjesëve të verifikuara të lëndës dhe shmangien e rishqyrtimit të panevojshëm të tyre.

Si rezultat, krijohet punë e dyfishtë për zyrtarët aprovues, zgjatet koha e shqyrtimit dhe aprovimit të lëndëve, ulet efikasiteti i procesit dhe me zgjatjen e kohës së shqyrtimit të lëndës krijohen edhe vonesa në ofrimin e shërbimeve ndaj palëve.

5. Mangësi në funksionalitetet e raportimit të të dhënave në sistemin e Regjistrit të Bizneseve të Kosovës (RBK)

ARBK duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final. [12]

Sistemi i RBK-së nuk mundëson gjenerimin e raporteve të detajuara të bizneseve sipas komunës. Zyrtarët komunal mund të gjenerojnë raporte vetëm për lëndët që i kanë procesuar vetë, ndërsa nuk kanë mundësi të gjenerojnë një raport të plotë dhe të detajuar për të gjitha lëndët e komunës së tyre. Në portal mund të shfaqen vetëm statistika të përgjithshme, ndërsa mungon mundësia për nxjerrjen e raporteve analitike në nivel komunal.

- Po ashtu, statistikat e sistemit nuk pasqyrojnë numrin real të bizneseve pasive, pasi përfshijnë edhe bizneset të cilat nuk kanë ndryshuar certifikatën e biznesit me Numrin Unik Identifikues (NUI). Si rezultat, numri i bizneseve pasive të paraqitura në sistem prej mbi 93 mijë mund të ndryshon nga gjendja reale sepse një pjesë e tyre mund të jenë duke ushtruar aktivitet ekonomik.
- Përveç pjesës së raportimit kemi evidentuar që edhe te qasja e lëndëve në komuna ka mangësi. Sistemi është i ndërtuar që të ofroj qasje të kufizuar në lëndë sipas komunës ku është bërë aplikimi, mirëpo ne kemi evidentuar se ka raste kur sistemi ka lejuar qasje në lëndë ose në të dhëna të komunave të tjera. Gjatë auditimit vërejtëm një rast kur pala kishte aplikuar online për informata, mirëpo gjatë hapjes së kërkesës sistemi kishte shfaqur të dhënat e një biznesi tjetër nga një komunë krejtësisht tjetër, duke ekspozuar informata që nuk i përkisnin aplikuesit, të cilat informata të cilat zyrtari i kishte raportuar në ARBK. Poashtu, është identifikuar rasti kur aplikimi është shpërndarë gabimisht për procesim në komunën jo përkatëse. Konkretisht, një biznes kishte bërë aplikimin në një komunë tjetër, mirëpo aplikimi ishte shfaqur për procesim në Komunën e Ferizajt. Ky rast ishte raportuar nga komuna në ARBK.

Sipas zyrtarëve të ARBK-së, shkaku i mungesës së funksionalitetit për gjenerimin e raporteve të detajuara në nivel komunal është arsyetuar me faktin se shumica e komunave nuk kanë udhëheqës të divizioneve dhe për këtë arsye, nuk është parë e nevojshme krijimi i këtij funksionaliteti. Edhe pse me marrëveshjen që kanë të nënshkruara komunat me ARBK-në, ishte paraparë që organizimi i komunave për regjistrimin e bizneseve të bëhej me udhëheqës të divizioneve, mirëpo, kjo nuk është zbatuar në praktikë nga komunat, si mungesë e stafit të angazhuar. Por ARBK, raportet për secilën komunë i gjeneron nga niveli qendror.

[12]Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

Ndërsa lidhur me mospërditësimin e bizneseve joaktive dhe Numrit Unik Identifikues (NUI), ARBK ka theksuar se procesi nuk është realizuar plotësisht për shkak se ligji për shoqëri tregtare nuk krijon obligim dhe që t'i mundësoj ARBK-së që të detyroj bizneset të përditësojnë të dhënat, gjithashtu nuk ka akte nënligjore që rregullojnë këtë çështje. Ndërsa shkak për rastet e shpërndarjes së gabuar të aplikimeve dhe shfaqjes së të dhënave të bizneseve të tjera tregojnë për mangësi në kontrollet e aplikacionit dhe në logjikën e funksionimit të sistemit, për të cilat ARBK nuk kishte identifikuar problemin.

Si rezultat i këtyre mangësive, kufizohet mundësia për monitorim dhe raportim efektiv të lëndëve dhe bizneseve në nivel komunal, duke ndikuar në efikasitetin e proceseve dhe cilësinë e vendimmarrjes. Gjithashtu, rritet rreziku i procesimit dhe ekspozimit jo të saktë të lëndëve, duke cenuar besueshmërinë e sistemit të RBK-së.

6. Mos realizim i plotë i procesit të regjistrimit dhe ç'regjistrimit të bizneseve në mënyrë elektronike

ARBK duhet të siguroj se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[13]

Megjithëse procesi i aplikimit për regjistrimin e biznesit mund të iniciohet dhe të realizohet online përmes sistemit të RBK-së, procesi nuk është i digjitalizuar në tërësi. Pas përfundimit të regjistrimit, pajisja me certifikatën e biznesit ende realizohet në formë fizike, ku pala duhet të paraqitet fizikisht për marrjen e dokumentit. Gjithashtu sa i përket pagesës së shërbimit në sistemin e RBK-së, pala duhet të shkarkojë fletëpagesën dhe më pas të ngarkojë dëshminë e pagesës, pasi sistemi nuk është i integruar me pagesa elektronike.
E njëjta qasje aplikohet edhe për shërbimet tjera, si:

- kërkesat për ndryshim të të dhënave të biznesit;
- kërkesat për lëshim të certifikatës duplikat;
- kërkesat për informata nga RBK.

Edhe pse kërkesa dhe aplikimi iniciohen përmes sistemit elektronik, marrja e dokumenteve përfundimtare vazhdon të bëhet vetëm në formë fizike.
Ndërsa përmes platformës e-Kosova qytetari përveç që mund të aplikoj online për regjistrimin e biznesit, gjithashtu përmes platformës mund të:

- shkarkoj në formë elektronike certifikatën;
- dokumenti nënshkruhet elektronikisht përmes mekanizmave të platformës;
- pagesat realizohen përmes shërbimit për realizimin e pagesave elektronike në e-Kosova në kohë reale.

Mirëpo, edhe në platformën e-Kosova ende nuk janë mundësuar të realizohen shërbimet për ndryshimin dhe ç'regjistrimin e biznesit.

Po ashtu, një kufizim tjetër në digjitalizimin e plotë të proceseve lidhet me vërtetimin tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Për procedurat e çregjistrimit/shuarjes së biznesit, pala duhet të sjellë vërtetimin tatimor fizik, të vulosur nga ATK-ja, në formë fizike.
ARBK ka ndërlidhje direkte me sistemet e ATK-së. Megjithatë, ATK aktualisht nuk e ka ofruar këtë mundësi të ofrimit të informacionit mbi obligimet tatimore në formë elektronike, prandaj ky proces ende realizohet përmes dokumenteve fizike.

[13] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

Shkaqet për këto mangësi janë kufizime të natyrës ligjore lidhur me eliminimin e dokumenteve fizike. Prandaj, në sistemin e RBK-së procesi i pajisjes me certifikatë dhe ruajtja e lëndës vazhdon të bëhet fizikisht. Ndërsa në e-Kosova është mundësuar që procesi të realizohej tërësisht online, me përjashtim të shërbimeve për ndryshim dhe ç'regjistrim të biznesit që nuk janë zhvilluar ende dhe janë në proces të zhvillimit me kontratën e re të mirëmbajtjes dhe avancimit të platformës e-Kosova. Gjithashtu, në sistemin e RBK-së nuk është realizuar mundësia e nënshkrimit elektronik, edhe në rast të ndryshimeve ligjore. Mirëpo, platforma e-Kosova tashmë e ofron mundësinë e përdorimit të nënshkrimit elektronik. Ndërsa, mungesa e integrimit të plotë ndërmjet RBK-së dhe platformave të ATK-së, për shkëmbim automatik të informatave të nevojshme për procedurat e çregjistrimit, ka ndikuar në mungesën e digjitalizimit të plotë për të cilin proces. ARBK ka diskutuar me ATK-në që përmes një kërkese elektronike nga RBK-ja, ATK-ja do të mund të kthente automatikisht informacionin nëse biznesi ka ose nuk ka obligime tatimore, dhe në rast mungese të obligimeve, sistemi do të mund të vazhdonte automatikisht me çregjistrimin.

Si rezultat i këtyre mangësive, proceset e regjistrimit, ndryshimit dhe çregjistrimit të bizneseve nuk realizohen plotësisht në mënyrë elektronike, duke krijuar varësi nga dokumentacioni fizik dhe procedurat manuale. Kjo ndikon në zgjatjen e kohës së përpunimit, rritjen e ngarkesës administrative, kufizimin e përfitimeve nga digjitalizimi. Gjithashtu, mungesa e integrimeve ndërmjet sistemeve kufizon automatizimin dhe efikasitetin e shërbimeve për bizneset.




Figura 3. Kontrollet e Sigurisë

7. Mungesë e kompleksitetit të fjalëkalimeve në sistemin e RBK-së

Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit[14].

Gjatë auditimit është identifikuar se sistemi i Regjistrit të Bizneseve të Kosovës nuk ka zbatuar kërkesa të mjaftueshme për kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve. Në kohën e auditimit,

[14]Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

përdoruesit e sistemit nuk ishin të detyruar të përdornin fjalëkalime që plotësonin kriteret minimale të sigurisë dhe as t'i ndryshonin ato periodikisht.
ARBK ka deklaruar se është në proces të implementimit të një mekanizmi të ri për rritjen e kompleksitetit të fjalëkalimeve, mirëpo gjatë fazës së auditimit nuk ishte i zbatuar. Ky implementim filloj të realizohet pas identifikimit të çështjes nga auditimi, si masë e përkohshme deri në hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës zyrtare për menaxhimin e fjalëkalimeve.

Mungesa e kompleksitetit të fjalëkalimeve ka ardhur si rezultat i mungesës së politikave dhe procedurave të formalizuara për sigurinë e informacionit, përfshirë mungesën e një politike të miratuar për menaxhimin e fjalëkalimeve. Sipas ARBK-së, kjo situatë lidhet me kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe organizative, mungesën e një strukture të formalizuar të qeverisjes së sigurisë së informacionit.

Si rezultat i mungesës së kërkesave të mjaftueshme për kompleksitetin dhe menaxhimin e fjalëkalimeve rrit rrezikun e kompromet imit të kredencialeve të përdoruesve. Si pasojë, mund të mundësohet qasje e paautorizuar në sistemin e RBK-së. Për më tepër, mungesa e një politike të formalizuar për menaxhimin e fjalëkalimeve krijon rrezik që kontrollet e sigurisë të mos zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe uniforme për të gjithë përdoruesit e sistemit.

8. Mangësi në menaxhimin e ndryshimeve dhe ndarjen e përgjegjësive në sistemin e RBK-së

Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për ndarjen e roleve, detyrave dhe përgjegjësive.

ARBK nuk ka një politikë dhe procedurë të formalizuar për menaxhimin e ndryshimeve (Change Management) në sistemet e informacionit.
Megjithatë, në praktikë ekziston një proces i brendshëm për menaxhimin e ndryshimeve. Çdo kërkesë për ndryshim ose zhvillim të ri iniciohet nga menaxhmenti i ARBK-së dhe i përcillet zyrtarit përgjegjës të Teknologjisë së Informacionit.
Pas pranimit të kërkesës, zyrtari i TI-së:

- kryen analizën teknike dhe funksionale;
- vlerëson ndikimin e ndryshimit;
- planifikon dhe koordinon zhvillimin;
- realizon testimin;
- mbikëqyr implementimin e ndryshimit në sistem;
- monitoron procesin deri në përfundim.

Pas zhvillimit, ndryshimet implementohen fillimisht në mjedisin testues, ku verifikohen funksionalitetet e reja dhe ndikimet në funksionalitetet ekzistuese. Para ndryshimeve që mund të ndikojnë në integritetin ose disponueshmërinë e të dhënave, realizohen kopje rezervë.
Vetëm pas përfundimit të testimeve dhe konfirmimit se ndryshimi funksionon sipas kërkesave, ai implementohet në mjedisin real (production).
Megjithatë, aktualisht nuk ekziston një grup formal pune për aprovimin dhe menaxhimin e ndryshimeve. Për shkak të numrit të kufizuar të stafit të TI-së, i gjithë procesi mbështetet kryesisht te një zyrtar i vetëm i TI-së, i cili kryen rolet e analizës, testimit të zhvillimit, aprovimit teknik dhe implementimit.

Shkaktarët kryesorë janë: mungesa e një procedure të dokumentuar për menaxhimin e ndryshimeve; numri i kufizuar i stafit të ARBK-së dhe TI-së, ku një zyrtar mbulon shumicën e roleve

në ciklin e ndryshimit; mungesa e një strukture të formalizuar për ndarjen e detyrave dhe aprovimin e ndryshimeve.

Si rezultat i mungesës së një procedure të formalizuar për menaxhimin e ndryshimeve dhe përqendrimit të shumicës së roleve te një zyrtar i vetëm i TI-së, dobësohen kontrollet e brendshme mbi procesin e ndryshimeve në sistemin RBK-së. Kjo krijon rrezik për: mungesën e ndarjes së duhur të detyrave ndërmjet inicimit të kërkesës, analizës, zhvillimit, testimit, aprovimit dhe implementimit të ndryshimeve; rritjen e varësisë nga një person i vetëm për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit; implementimin e ndryshimeve pa kaluar nëpër kontrolle të plota dhe rishikime të pavarura para kalimit në mjedisin real. Si pasojë, rritet rreziku që ndryshimet e realizuara në sistem të ndikojnë negativisht në integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe funksionaliteteve të RBK-së.

9. Mungesë e procedurave të formalizuara për Kopjen rezervë dhe Rikthimin nga Fatkeqësia në nivel të ARBK-së

Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit. [15]

ARBK nuk posedon procedura të formalizuara dhe të dokumentuara për menaxhimin e Kopjes rezervë dhe Rikthim nga Fatkeqësia, pra ka mungesë të politikave dhe planit për vazhdimësinë e biznesit.
Infrastruktura harduerike e ARBK-së është e hostuar në Agjencinë Shtetërore të Informacionit((ASHI), e cila është përgjegjëse për sigurinë, disponueshmërinë, si dhe zbatimin e procedurave operative për backup dhe vazhdimësi të shërbimeve.
Procesi i backup-it realizohet në përputhje me nenin 8 të Rregullores (MAP) Nr. 01/2018 për Bazat e të Dhënave Elektronike. Prandaj, në praktik aktualisht realizohen:

- Kopje rezervë (backup) diferencial dhe log backup ditor;
- Kopje rezervë e plotë (full backup) një herë në javë;
- Kopje rezervë e makinës (machine backup) çdo shtatë ditë.

Kopjet rezervë ruhen në tri kopje dhe në lokacione të ndryshme:
Ndërsa, sa i përket Rikthimit nga Fatkeqësia "Disaster Recovery", ARBK mbështetet në infrastrukturën e ASHI-së. ASHI, ende nuk ka krijuar një zgjidhje për zbatimin e "Rikthimit nga fatkeqësia" por, ka ndërmarr hapa dhe është në proces për zhvillimin e zgjidhjes.

Shkak kryesor është mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për hartimin e procedurave të brendshme për Kopjen rezervë dhe Rikthim nga Fatkeqësia.

Mungesa e procedurave të formalizuara për menaxhimin e kopjes rezervë dhe rikthim nga fatkeqësia kufizon qartësinë mbi përgjegjësitë dhe mënyrën e veprimit në rast të incidenteve. Si rezultat: rritet rreziku që rikthimi i të dhënave dhe shërbimeve të mos realizohet në mënyrë të koordinuar dhe brenda afateve të përcaktuara; kufizohet gatishmëria e ARBK-së për reagim dhe vazhdimësi të operimit në rast të ndërprerjeve ose fatkeqësive.

[15]Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

4 Konkluzionet

Bazuar në vlerësimin e kontrolleve të aplikacionit dhe sigurisë së aplikacionit për Sistemin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (RBK), është konstatuar se sistemi paraqet një platformë të rëndësishme për digjitalizimin dhe mbështetjen e proceseve të regjistrimit, menaxhimit dhe administrimit të të dhënave të bizneseve në Kosovë. Sistemi ka kontribuar në standardizimin e proceseve, centralizimin e informatave dhe lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet ARBK-së, komunave dhe qytetarëve, duke ofruar një bazë të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve elektronike.

Megjithatë, bazuar në vlerësimin e kontrolleve të aplikacionit dhe sigurisë së aplikacionit, është konstatuar se kontrollet e implementuara nuk sigurojnë në tërësi nivelin e nevojshëm të automatizimit, validimit, raportimit dhe sigurisë së informacionit

Kontrollet e hyrjes

Kontrollet e hyrjes në procesin e regjistrimit të bizneseve përmes sistemit RBK dhe platformës e-Kosova nuk sigurojnë në tërësi validimin e nevojshëm të të dhënave hyrëse dhe udhëzimin adekuat të përdoruesve gjatë aplikimit. Edhe pse sistemi përmban disa kontrolle bazë, janë identifikuar mangësi në identifikimin e fushave obligative, validimin e të dhënave dhe zbatimin e kërkesave ligjore në mënyrë automatike. Mungesa e shënimit të qartë të fushave obligative, mungesa e udhëzimeve për plotësimin e tyre dhe mesazhet e përgjithshme të gabimit e vështirësojnë procesin për qytetarët dhe rrisin mundësinë për plotësim jo të saktë të aplikimeve. Gjithashtu, mungesa e funksionaliteteve të plota për ndryshimin dhe çregjistrimin e bizneseve në e-Kosova tregon se procesi i digjitalizimit të shërbimeve nuk është realizuar plotësisht. Po ashtu, kontrollet automatike të sistemit nuk sigurojnë zbatimin e plotë të kërkesave ligjore, siç është kriteri për dallueshmërinë e emrit të biznesit. Lejimi i regjistrimit të emrave të bizneseve me dallime minimale nga emrat ekzistues rrit nevojën për verifikime manuale nga zyrtarët dhe krijon rrezik për konfuzion në identifikimin e bizneseve.

Gjithashtu, mungesa e specifikimit të kërkesave funksionale nga ekspertë të fushës para zhvillimit të sistemit ka ndikuar që disa rregulla biznesore dhe interpretime ligjore të mos jenë të integruara në kontrollet automatike të aplikacionit. Kjo ka rezultuar në raste kur aplikimet lejohen të dorëzohen me të dhëna që më pas kërkojnë korrigjim manual nga zyrtarët.

Në përgjithësi, kontrollet e hyrjes në sistemin RBK kërkojnë përmirësim përmes forcimit të validimeve automatike, integrimit të kërkesave ligjore dhe biznesore në funksionalitetet e sistemit, si dhe përmirësimit të ndërfaqes së përdoruesit.

Kontrollet dalëse

Kontrollet dalëse të sistemit të Regjistrit të Bizneseve të Kosovës (RBK) nuk ofrojnë mbështetje të plotë për raportim efektiv, monitorim të proceseve dhe automatizim të shërbimeve. Edhe pse sistemi mundëson menaxhimin bazë të aplikimeve dhe lëndëve, janë identifikuar mangësi në funksionalitetet e raportimit, kontrollin e të dhënave dhe digjitalizimin e proceseve.

Mungesa e raporteve të detajuara në nivel komunal dhe pasaktësitë në statistikat e sistemit, ndikojnë në monitorimin e informatave dhe vendimmarrje.

Proceset e regjistrimit, ndryshimit dhe çregjistrimit të bizneseve nuk janë tërësisht elektronike, pasi vazhdojnë të kërkojnë dokumente dhe veprime fizike për shkak të mungesës së disa funksionaliteteve dhe integrimeve të nevojshme. Po ashtu, mungesa e mekanizmave për kufizimin e ndryshimeve gjatë korrigjimit të lëndëve rrit ngarkesën e zyrtarëve dhe zgjat kohën e shqyrtimit të kërkesave, duke shkaktuar vonesa në regjistrimin e bizneseve.

Në përgjithësi, sistemi RBK kërkon përmirësim të kontrolleve dalëse për të siguruar saktësi më të lartë, raportim më efektiv, procese më të automatizuara dhe menaxhim më efikas të lëndëve, duke zvogëluar varësinë nga procedurat manuale dhe duke rritur cilësinë e shërbimeve për bizneset.

Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Kontrollet e sigurisë së aplikacionit në sistemin e Regjistrit të Bizneseve të Kosovës (RBK) janë pjesërisht të zbatuara, por kërkojnë përmirësim për të siguruar një nivel më të lartë të mbrojtjes së sistemit, të dhënave dhe vazhdimësisë së shërbimeve.

Edhe pse ARBK ka ndërmarrë disa masa teknike dhe operacionale, si proceset praktike për menaxhimin e ndryshimeve dhe realizimin e kopjeve rezervë përmes infrastrukturës së menaxhuar nga ASHI, mungesa e politikave, procedurave dhe kontrolleve të formalizuara kufizon efektivitetin e qeverisjes së sigurisë së aplikacionit.

Mangësitë në menaxhimin e kredencialeve të përdoruesve, përkatësisht mungesa e kërkesave të detyrueshme për kompleksitetin dhe menaxhimin e fjalëkalimeve, paraqesin dobësi në kontrollet e qasjes dhe rrisin rrezikun e kompromet imit të llogarive të përdoruesve. Gjithashtu, mungesa e një procesi të formalizuar për menaxhimin e ndryshimeve dhe përqendrimi i roleve kryesore të ciklit të ndryshimit te një zyrtar i vetëm i TI-së dobëson ndarjen e detyrave dhe kontrollin e pavarur të ndryshimeve në sistem.

Po ashtu, edhe pse proceset teknike të backup-it realizohen në praktikë, mungesa e procedurave të dokumentuara për Rikthim nga fatkeqësia kufizon gatishmërinë e ARBK-së për reagim të koordinuar dhe rikthim të shërbimeve në rast të incidenteve ose ndërprerjeve.

Në përgjithësi, kontrollet e sigurisë së aplikacionit në RBK kërkojnë forcim përmes hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave të formalizuara, përmirësimit të menaxhimit të qasjes, ndarjes së përgjegjësive në proceset kritike dhe përcaktimit të qartë të masave për vazhdimësinë e shërbimeve.

5 Rekomandimet

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, agjenci e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

1. **Përmirësimi i funksionaliteteve të shërbimit për regjistrimin e bizneseve në e-Kosova.** ARBK në bashkëpunim me ASHI-në, duhet të përmirësojë funksionalitetet e shërbimit për regjistrimin e bizneseve në e-Kosova, duke ofruar udhëzime dhe shembuj për plotësimin e fushave të aplikimit, duke i bërë të dallueshme fushat obligative, duke shfaqur mesazhe të qarta të gabimit që identifikojnë fushën përkatëse, si dhe duke mundësuar përcjelljen e statusit të lëndës gjatë procesit të aplikimit.

   1.1. Po ashtu, duhet të zhvillohen modulet për ndryshimin dhe çregjistrimin e biznesit në e-Kosova, me qëllim të zhvillimit të plotë të procesit përmes platformës e-Kosova.

2. **Përmirësimi i verifikimit të emrit të biznesit në përputhje me legjislacionin.** ARBK duhet të bëje kontrollimin në mënyrë automatike të emrit të biznesit në sistemin e regjistrimit të biznesit, në mënyrë që kontrolli i dallueshmërisë së emrit të zbatohet në përputhje me legjislacionin për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar, në mënyrë që verifikimet të kryhen nga sistemi dhe të mënjanohet kontrollimi manual i emrave të bizneseve nga zyrtarët shqyrtues në komuna dhe në ARBK.

3. **Përmirësimi i procesit të hartimit të kërkesave për zhvillimin e sistemit.** ARBK-ja duhet të caktoj personat përgjegjës për hartimin e kërkesave për zhvillimet në sistem duke përfshirë profesionistë të fushave të legjislacionit për pjesën biznesore të kërkesave, në mënyrë që edhe hapësirat ligjore të interpretohen saktë dhe zhvillohen saktë në funksionalitete të sistemit.

4. **Funksionalitetet e raportimit.** ARBK duhet të zhvillojë dhe aktivizojë funksionalitete që mundësojnë gjenerimin e raporteve të plota dhe të detajuara në nivel komunal, duke u mundësuar zyrtarëve të autorizuar komunalë qasje në raportet për të gjitha lëndët e komunës përkatëse, jo vetëm për lëndët që i kanë procesuar individualisht.
   4.1. ARBK duhet të rishikojë dhe përmirësojë mekanizmat e raportimit dhe statistikave të sistemit, në mënyrë që të dhënat e paraqitura të reflektojnë gjendjen reale të bizneseve aktive dhe pasive, duke siguruar përditësimin e Numrit Unik Identifikues (NUI) përmes bashkëpunimit institucional me Inspektoratin e Tregut dhe Administratën Tatimore të Kosovës.
   4.2. ARBK duhet të rishikojë kontrollet e aplikacionit dhe rregullat e shpërndarjes së lëndëve, duke siguruar që lënda të trajtohet dhe procesohet vetëm nga qasja e komunës përkatëse.

5. **Digjitalizimi i plotë i procesit.** ARBK duhet të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për rishikimin dhe harmonizimin e kërkesave ligjore dhe procedurale, veçanërisht sa i përket dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-016, me qëllim të identifikimit të mundësive për zbatimin e proceseve elektronike.

   5.1. ARBK duhet të rishikojë dhe përmirësojë funksionalitetet e sistemit të RBK-së, dhe zhvillojë mundësinë e nënshkrimit elektronik, duke mundësuar përfundimin e shërbimeve në mënyrë

tërësisht elektronike, përfshirë lëshimin dhe shkarkimin e certifikatave elektronike, ndryshimet në të dhënat e biznesit, certifikatat duplikat dhe kërkesat për informata. **5.2.** ARBK duhet të zhvillojë integrime elektronike me institucionet tjera relevante, veçanërisht me Administratën Tatimore të Kosovës, për shkëmbimin automatik të informatave të nevojshme për procedurat e çregjistrimit/shuarjes së bizneseve, në mënyrë që verifikimi i obligimeve tatimore të realizohet përmes ndërveprimit të sistemeve elektronike dhe jo përmes dokumenteve fizike.

6. **Procesi i korrigjimit të lëndës.** ARBK duhet të rishikojë dhe përmirësojë funksionalitetin e sistemit të RBK-së për menaxhimin e lëndëve të kthyera për korrigjim, duke siguruar një proces më të kontrolluar të ndryshimeve dhe duke ruajtur fleksibilitetin e nevojshëm për palët (Biznesin dhe Zyrtarin Aprovues).

7. **Kompleksiteti i fjalëkalimeve.** ARBK duhet të sigurojë hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës dhe procedurave për menaxhimin e fjalëkalimeve, si pjesë e kornizës së sigurisë së informacionit, si dhe të përfundojë implementimin e mekanizmit në sistemin e RBK-së që zbaton kërkesat minimale për kompleksitetin e fjalëkalimeve dhe ndryshimin periodik të tyre.

8. **Menaxhimi i ndryshimeve dhe ndarja e përgjegjësive në sistemin e RBK-së.** ARBK duhet të sigurojë hartimin, miratimin dhe zbatimin e një politike dhe procedure të formalizuar për menaxhimin e ndryshimeve në sistemet e informacionit, e cila përcakton qartë hapat e procesit, kriteret për vlerësim, testim, aprovim, dokumentim dhe implementim të ndryshimeve. **8.1.** Gjithashtu, duhet të krijojë një strukturë të përshtatshme për aprovimin dhe mbikëqyrjen e ndryshimeve, duke siguruar ndarjen e detyrave ndërmjet roleve, në mënyrë që të reduktohet varësia nga një person i vetëm dhe të forcohen kontrollet e brendshme mbi ciklin e menaxhimit të ndryshimeve.

9. **Kopja rezervë dhe Rikthimi nga fatkeqësia.** ARBK-ja duhet të sigurojë hartimin, miratimin dhe zbatimin e procedurave të formalizuara për menaxhimin e kopjes rezervë dhe rikthimit nga fatkeqësia, si pjesë e planit për vazhdimësinë e biznesit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë, proceset e rikthimit të të dhënave, afatet e rikuperimit dhe mënyrën e koordinimit me AShI-në. **9.1.** Gjithashtu, ARBK në bashkëpunim me AShI-në duhet të sigurojë zhvillimin dhe testimin periodik të një zgjidhjeje për rikthim nga fatkeqësia, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve kritike dhe zvogëlimin e rrezikut nga ndërprerjet e mundshme të sistemit RBK.

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit

Rëndësia e sistemit të regjistrimit të bizneseve qëndron në faktin se ai mundëson ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset, duke përfshirë krijimin e llogarisë, aplikimin për regjistrim të biznesit, si dhe paraqitjen e kërkesave për ndryshim dhe menaxhimin e të dhënave. Përmes këtij sistemi, bizneset mund të kryejnë procedura në mënyrë të digjitalizuar, çka kontribuon në rritjen e efikasitetit institucional dhe reduktimin e procedurave manuale. Materialiteti i tij është i lartë jo vetëm për shkak të rolit operacional, por edhe për ndikimin që ka në transparencë, integritetin e të dhënave dhe cilësinë e shërbimeve për një numër të madh përdoruesish.

Përveç të dhënave me vlerë për bizneset dhe menaxhimin dhe monitorimin e tyre më të lehtë përmes këtij regjistri ky sistem zvogëlon shpenzimet dhe rrit sigurinë dhe besueshmërinë e të dhënave edhe për platformat tjera që i nevojiten të dhënat e bizneseve.

Për rëndësinë që ka Ministria për bizneset është theksuar edhe në Raportin vjetor për Kosovën të Komisionit Evropian, ku është theksuar se:

"Kosova është mesatarisht e përgatitur dhe ka bërë progres të kufizuar duke vazhduar zbatimin e Strategjisë 2030 për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve."

Rekomandimet e Komisionit Evropian nga viti i kaluar janë zbatuar vetëm në një masë të kufizuar dhe mbeten kryesisht ende të vlefshme. Në periudhën e ardhshme, Kosova duhet në veçanti të:

- Të avancojë me zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetjen e Bizneseve 2030, si dhe të shtyllës së rritjes së qëndrueshme ekonomike të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2021–2030;
- Të përmirësojë urgjentisht kapacitetet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Të përfundojë themelimin e dy agjencive të ndara, një për promovimin e investimeve dhe një për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe të sigurojë që të dyja të kenë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike për funksionimin e tyre efektiv.

Pavarësisht kornizës strategjike të këtij raporti, sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në raste të caktuara në praktikë, ku, sipas disa burimeve të raportuara në media zyrtare, në ARBK lidhet me një hetim, me një rast me ndryshimin e të dhënave të pronësisë së një biznesi pas vdekjes së pronarit. Gjatë diskutimeve tona në ARBK gjatë fazës së planifikimit, na u sqarua që hetimet për zyrtarët e institucionit kanë pushuar dhe janë sqaruar rrethanat. Prandaj, si problem na orienton në kontrollet e sigurisë lidhur me qasjet dhe mundësitë e ndryshimit në sistem.

Sipas, raportit të ARBK-së "Raporti i indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë", problem kryesor janë vonesat në regjistrim. Koha mesatare për regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare në T2 2023 ishte 5.99 ditë, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2022 ishte 3.70 ditë. Kjo paraqet një rritje prej 62% të kohëzgjatjes së regjistrimit, që nënkupton se bizneset po regjistrohen më ngadalë se më parë. Prandaj, si problem na orienton në kontrollet hyrëse të aplikacionit.

Gjithashtu, sfidë e zbatimit në sistem u prezantua edhe legjislacioni i pa përditësuar, apo në disa raste edhe jo mirë i harmonizuar. Që na orienton në kontrollet dalëse të aplikacionit dhe pjesa që trajtohet nga domeni "Qeverisja e TI-së" do të trajtohet si shkak në pjesën e kontrolleve të aplikacionit, legjislacioni si pjesë e kontrolleve hyrëse dhe dalëse, ndërsa struktura dhe qasja në pjesën e kontrolleve të sigurisë së aplikacionit.

Të gjitha këto sfida tregojnë që sistemi ka nevojë për përmirësime në aspektin e digjitalizimit dhe efikasitetit, në mënyrë që shërbimet për bizneset të jenë më të shpejta, më të sakta dhe më të lehta për përdorim.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve për sistemin e regjistrimit te bizneseve, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së[16] për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: sistemi i regjistrimit te bizneseve ka mangësi në kontrollin e aplikacionit, që përfshihen kontrollet hyrëse, dalëse dhe ato të sigurisë së aplikacionit.

Përshkrimi i sistemit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit administron sistemin e regjistrimit të bizneseve që nga 13 shtatori 2001. Në bazë të dispozitave të rregulloreve 2001/6 dhe Urdhëresës Administrative 2002/22 është themeluar Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Afariste dhe Emrave Tregtar të Kosovës. Zyra e regjistrimit zyrtarisht është hapur më 11 Nëntor 2002 si Agjenci e Pavarur Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit. Kjo zyre regjistrimet e para i ka pranuar prej datës 13 Mars 2003, ku edhe ka pushuar pranimi i dokumentacionit të përkohshëm.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve bën regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare dhe shoqërive të huaja tregtare konform Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare si dhe Ligjit Nr.06/L-016 për ndryshimet dhe plotësimin e ligjit për Shoqëritë Tregtare, ofron informacione si dhe shërbimet me Zyrën e Statistikës, Administratën Tatimore, Doganat, Shërbimin Policor si dhe të tjera Agjenci.

[16] Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAI dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kritereve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

Më poshtë, përmes diagramit, është paraqitur struktura organizative e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që do të përfshihet në auditim për administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e sistemit për regjistrimin e bizneseve.




Figura 4. Struktura organizative e ARBK-së për sistemin e regjistrimit të bizneseve.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur i gjithë procesi i funksionimit të sistemit, duke filluar nga regjistrimi i biznesit e deri tek shqyrtimi dhe aprovimi i aplikacionit.




Figura 5. Cikli nga regjistrimi i biznesit deri tek shqyrtimi dhe aprovimi i aplikacionit.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK)

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. ARBK është institucion i orientuar drejtë zhvillimit që ofron arritjen e efikasitetit, me një cilësi të lartë për të gjithë operatorët ekonomik që operojnë në Kosovë.

Përmes rrjetit të 36 qendrave komunale të regjistrimit, të lidhura me zyrën qendrore të ARBK-së, ofrohet një shërbim i unifikuar dhe i koordinuar në të gjithë territorin e Kosovës. Ky sistem "one-stop-shop" është krijuar për të ofruar një përvojë të lehtë dhe efikase për bizneset, duke ulur burokracinë dhe duke rritur transparencën.

Misioni i ARBK-së është të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e biznesit në Kosovë, duke ofruar shërbime të besueshme dhe efikase. Që synon të harmonizojë procedurat me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke e bërë regjistrimin e bizneseve sa më të lehtë dhe të standardizuar.

Qendrat Komunale

ARBK ofron një zgjidhje "one-stop-shop" për regjistrimin e biznesit në mbarë Kosovën, duke qenë bazë qendrore e të dhënave të unifikuara të centralizuara në 36 qendrat komunale.

Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

Sistemi i Regjistrit të Bizneseve në Kosovë është një platformë elektronike që u mundëson përdoruesve të regjistrohen në sistem dhe të aplikojnë online për regjistrimin e bizneseve, gjithashtu ofron qasje edhe përmes qasjes së tyre në platformën e-Kosova, si dhe të paraqesin kërkesa për ndryshime dhe shërbime të tjera administrative. Pas konfirmimit të llogarisë, përdoruesit mund të menaxhojnë të dhënat e bizneseve të tyre në mënyrë elektronike.

Sistemi për regjistrimin e bizneseve përfshin një gamë të gjerë funksionesh që mbulojnë të gjithë ciklin jetësor të një biznesi, nga krijimi fillestar deri te ndryshimet dhe ç'regjistrimi, që deri më tani online në platformën e-Kosova është zbatuar vetëm pjesa e regjistrimit.

Procesi i regjistrimit realizohet përmes disa hapave. Përdoruesi pas identifikimit në platformë, zgjedh llojin e biznesit dhe vazhdon me plotësimin e formularëve përkatës. Sistemi kërkon plotësimin e të dhënave personale të pronarit, të dhënave të biznesit, aktiviteteve ekonomike, adresës së biznesit dhe përfaqësuesve të autorizuar. Gjithashtu, përdoruesi duhet të ngarkojë dokumentet e nevojshme për regjistrim, si dokumentet identifikuese dhe formularët e kërkuar nga sistemi. Sistemi u mundëson përdoruesve regjistrimin e llojeve të ndryshme të bizneseve si Biznes Individual, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK), Shoqëri Aksionare, Ortakëri të Përgjithshme, Ortakëri të Kufizuara, Kompani të Huaja dhe Kooperativa Bujqësore.

Në sistemin për regjistrimin e bizneseve, përveç regjistrimit të bizneseve, sistemi ofron edhe mundësinë për ndryshimin e të dhënave të biznesit, ndryshimin e adresës, aktiviteteve, kapitalit, pronarëve, përfaqësuesve dhe çregjistrimin e biznesit.

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të jetë Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), me qendrat komunale për regjistrimin e bizneseve (gjatë këtij auditimi janë përzgjedhur dy qendra komunale si mostra testuese), e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Regjistrimit të Bizneseve dhe divizioni përkatës për administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Fokus i auditimit do të jenë kontrollet e aplikacionit për Sistemin për regjistrimin e bizneseve në Kosovë. Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2026, duke përfshirë edhe kontratën fillestare me termat e referencës për zhvillimin e sistemit të vitit 2019.

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën kontrollet e aplikacionit, duke i përzgjedhur fushat e auditimit si në vijim:

1. Kontrollet e Aplikacionit

1.1. Kontrollet e hyrjes

1.3. Kontrollet e të dhënave dalëse

1.4. Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Pyetjet audituese

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A ka Sistemi për Regjistrimin e Bizneseve kontrolle të përshtatshme për vlefshmërinë e të dhënave hyrëse?*

2. *A vlerësohet nëse të dhënat e vendosura gjatë hyrjes në sistem janë futur në bazën e të dhënave në Sistemin e Regjistrit të Bizneseve nga personeli i autorizuar?*
3. *A përmban Sistemi për Regjistrimin e Bizneseve kontrolle që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e rezultateve?*

4. *A është e organizuar në mënyrën e duhur ruajtja e rezultatit të të dhënave?*

5. *A janë të mjaftueshme mekanizmat e gjurmimit në Sistemin për Regjistrimin e Bizneseve?*

6. *A mbrohet informacioni i Sistemit për Regjistrimin e Bizneseve në mënyrë të duhur kundër keqpërdorimit?*

Kriteret e auditimit[17]

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së[18], si dhe ligji dhe aktet nën ligjore në fuqi për Sistemin e Regjistrit të Bizneseve në Kosovë.

Për të vlerësuar se për sistemin e integruar informativ për Sistemin e Regjistrit të Bizneseve në Kosovë ekzistojnë mekanizma kontrollues të aplikacionit të cilët mundësojnë plotësinë, saktësinë dhe qasjen e sigurt në sistemi i regjistrit të bizneseve janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Rregullat e vlefshmërisë në sistemin për regjistrimin e bizneseve duhet të jenë të mirë-hartuara, të dokumentuara dhe të zbatuara në ndërveprimin e hyrjeve (inputit); duhet të dokumentohen metoda të ndryshme për futjen e të dhënave; të dhëna jo valide duhet të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni; kriteret e vlefshmërisë përditësohen në mënyrën e duhur dhe të autorizuar; duhet të ekzistojnë kontrolle gjithëpërfshirëse si rregulla regjistrimi dhe autorizimi në rast të mundësisë së tejkalimit të kontrolleve thelbësorë të hyrjes; ka kontrolle dhe dokumentim të duhur për hyrjet e aplikacionit.[19]

- ARBK duhet të ketë të hartuara procedurat për të siguruar se plotësia dhe saktësia rezultateve të aplikacioneve është vlerësuar përpara përdorimit të rezultatit nga përpunimi i mëtejshëm, përfshirë përpunimin e përdoruesve final; të mundësohet gjurmimi i rezultatit të aplikacionit; rezultati të rishikohet për arsyeshmëri dhe saktësi; kontrollet e plotësisë dhe të saktësisë të jenë efektive.[20]

- Të dhënat e aplikacionit duhet të mbrohen në përputhje me standardet e sigurisë dhe manualin e auditimit të TI-së. Duhet të zbatohen kontrolle efektive të qasjes logjike dhe fizike, siç përcaktohet në domainin mbi Sigurinë e Informacionit, për të siguruar autentifikimin, autorizimin dhe monitorimin e aksesit. Duhet të ekzistojnë gjurmë auditimi që regjistrojnë ndryshimet, tejkalimet dhe regjistrat e autorizimeve për transaksionet kritike; gjurmët e auditimit mirëmbahen dhe mbrohen në mënyrë adekuate; dhe çdo transaksioni i caktohet një numër ose identifikues unik dhe rendor. Gjithashtu, aplikacioni duhet të ketë një plan të dokumentuar për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, duke përfshirë mekanizma të sigurt të backup-it dhe rikuperimit, sipas domainit mbi PVB/PRF. Planet e sigurisë dhe rimëkëmbjes duhet të testohen rregullisht për të garantuar vijueshmërinë e biznesit dhe mbrojtjen e informacionit.[21]

[17] Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

[18] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

[19] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e hyrjes.

[5]Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e të dhënave dalëse

[6] Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollet e Aplikacionit, Kontrollet e sigurisë së aplikacionit

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

- Rishikimi dhe analizimi i dokumenteve kontraktuale. Kontratën fillestare për zhvillimin e ueb platformës të sistemit për regjistrimin e bizneseve. Kërkesat e ARBK-së (ana e biznesit për zhvillimin e funksioneve). Kërkesat e TI-së lidhur me zhvillimin dhe avancimin e sistemit. Raportet për zhvillimin e kërkesave.
- Rishikimi i kërkesave dhe rregullave të biznesit për ARBK-në. Analizimi i llojeve të të dhënave hyrëse. Kërkesat ligjore dhe të përputhshmërisë me rregulloret e jashtme. Struktura e ndërlidhjeve të të dhënave me sisteme të tjera. Diagramet e rrjedhës së sistemit. Manualet e përdoruesit. Rregullat e verifikimit.

- Analiza e ndërlidhjeve të sistemit për pranimin e të dhënave hyrëse.
  Verifikimi nëse kontrollet e validimit për futjen e të dhënave po zbatohen, duke vëzhguar përdoruesit e aplikacionit gjatë veprimit të tyre real; analizimi i regjistrave të të dhënave të ruajtura në bazën e të dhënave përmes përdorimit të veglave të auditimit.
  Vlerësim nëse kriteret dhe parametrat e validimit mbi të dhënat e inputit përputhen me rregullat e biznesit dhe nëse zbatojnë refuzimin e tipeve të inputit që nuk përputhen. Operatorët e bazës së të dhënave (si *, =, or, select) duhet të ndalohen si input të vlefshëm, pasi mund të përdoren për të ndërprerë ose për të marrë informacion nga baza e të dhënave. Intervistohen menaxherët nëse kriteret dhe parametrat e validimit mbi të dhënat e inputit rishikohen periodikisht, konfirmohen dhe azhurnohen në mënyrë të autorizuar dhe të përshtatshme.

  Rishikimi i diagramave të rrjedhës së sistemit dhe kodi i sistemit, dhe të intervistohen zhvilluesit ose administratorët e aplikacionit për të marrë informacion mbi ndërfaqet dhe kontrollet mbi to.

- Rishikimi i Listave të output-eve/raporteve elektronike. Mostër e output-it elektronik.

  Analizohen listat e të gjitha daljeve elektronike që ripërdoren në aplikacionet e përdoruesve fundorë zyrat e regjistrimit në ARBK. Verifikimi që dalja elektronike testohet për plotësinë dhe saktësinë e saj para se të ripërdoret dhe të ripërpunohet. Analizimi i bilancit dhe pajtueshmëria e daljes siç është përcaktuar nga metodat e dokumentuara. Përpunohen testet e plotësisë dhe saktësisë për të verifikuar që ato janë efektive. Shqyrtohet nëse çdo produkt dalës përmban: emrin ose numrin e programit të përpunimit; titullin ose përshkrimin; periudhën e përpunimit të mbuluar; emrin dhe vendndodhjen e përdoruesit; datën dhe kohën e përgatitjes; klasifikimin e sigurisë.
- Analiza e ndërlidhjeve të sistemit për shfaqjen e rezultateve për të dhënat dalëse.
- Rishikimi i dokumentacionit teknik të Sistemi i Regjistrit të Bizneseve me detajet e zbatimit. Rishikimi dokumentacioni i disponueshëm i zgjidhjes software/hardware dhe të intervistohet ekipi TI-së i ARBK-së për të vlerësuar kuptimin e tyre mbi mekanizmat e sigurisë të implementuar në aplikacion.

Dokumentet relevante

Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës ka miratuar ligje dhe udhëzime administrative të cilat përcaktojnë përgjegjësitë si dhe procesin e funksionimit të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës(ARBK) në Institucionet e Republikës së Kosovës.


2.1 Ligjet dhe Udhëzimet Administrative

Ligji Nr. 06 l - 016 Për Shoqëritë Tregtare
Ky ligj rregullon themelimin, regjistrimin, organizimin, funksionimin dhe shpërbërjen e shoqërive tregtare në Kosovë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, aksionarëve dhe organeve drejtuese të tyre.
Udhëzim Administrativ Qrk. Nr.-012019 për Caktimin e Kërkesave Kushteve dhe Procedurave për Krijimin e Numrit Unik Identifikues
Ky udhëzim administrativ përcakton kërkesat, kushtet dhe procedurat për krijimin dhe përdorimin e Numrit Unik Identifikues (NUI) për bizneset, i cili shërben si identifikues i vetëm për regjistrim, tatime dhe institucione të tjera, dhe lëshohet nga ARBK gjatë regjistrimit të biznesit.
Udhëzim Administrativ Qrk. Nr.-012019 për Caktimin e Kërkesave Kushteve
Ky udhëzim përcakton mënyrën e krijimit, përdorimit dhe administrimit të Numrit Unik Identifikues (NUI) për bizneset, i cili shërben si identifikues i vetëm për regjistrim, tatime dhe institucione të tjera dhe lëshohet nga ARBK gjatë regjistrimit të biznesit.
Udhëzimi Administrativ Nr. 12-2022, dt. 10.10.2022
Ky udhëzim përcakton taksat për shërbimet që ofron ARBK për bizneset, duke i bazuar ato vetëm në llojin e shërbimit (jo në kapital apo qarkullim), si dhe rregullon mënyrën e pagesës dhe procedurat përkatëse.
Udhëzimi Administrativ për Taksat e ARBK-së
Ky udhëzim përcakton taksat për shërbimet e ARBK-së për biznese të ndryshme, duke specifikuar llojet e shërbimeve dhe tarifat përkatëse, si dhe rregullon mënyrën e pagesës dhe administrimin e tyre.

Shtojca II. Letër konfirmimi







Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija / Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë/ Kosovska Agencija za Registracije Biznisa/ Kosova Business Registration Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit **Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës,** dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtine, 07/08/2026

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtori Ekzekutiv



Fahrije Tërnava



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës